



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received / Delivery	30. 03 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHON	1734/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 36 /2022
Datë:30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës .
2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Jeton KOÇA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
- Menaxherit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Këshillit.



DATE	INITIALS	DESCRIPTION	REMARKS

ANALYSIS OF SAMPLE

ANALYST: [Name]

DATE: [Date]
SAMPLE NO.: [Number]
METHOD: [Method]

DESCRIPTION OF SAMPLE: [Text]
ANALYSIS PROCEDURE: [Text]
RESULTS: [Text]

ANALYST'S SIGNATURE: [Signature]


DATE OF ANALYSIS: [Date]
LABORATORY: [Name]
ADDRESS: [Address]

THE UNIVERSITY OF CHICAGO
DEPARTMENT OF CHEMISTRY



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pamjena / Prodato Received / Delivery	30.03.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HC/1734/2022			1/11



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE
TË LEGJSLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

ZYRËN E KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	5-7
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	7-8
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	8-9
Procedurat Disiplinore.....	10
Procedurat e Ankesave.....	10
Procedurat e Vlerësimit.....	10
Procedurat e Pushimeve.....	10-11
Procedurat e Transferimit.....	11
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	11-12
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	12
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	12
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	13
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	13
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	13
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	13
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	14

HJRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e Shërbimit Civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, me datë 09.07.2020 (sipas Aktgjykimit nr. KO203/19, Publikuar: 13.07.2020, e gjeni tek Aktgjykimet, Gjykata Kushtetuese), Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorja Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlihen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullorja Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, përmes funksionit të monitorimit Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar "Udhëzuesin për procedurën e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil", mbi bazën e të cilit edhe harton "Planin e Monitorimit" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektivi i monitorimit ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për Shërbimin Civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve për realizimin e objektivit tonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas vlerësimit tonë dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike, lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORTI I PROCEDURËS SË MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL, NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKES SË KOSOVËS

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, për të vlerësuar drejtë në mënyrë të pa anshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Zyra e Kryeministrit, përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, të realizuar me datë 20.01.2022, në prezencë të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregullorja Nr.16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
- Plani individual i personelit (FPIP), 2020,
- Vendimi Nr.prot:012/2020 i datës 10.01.2020, për caktimin e ushtruesit të detyrës,
- Lista e nëpunësve civil për vitin 2020 në Zyrën e Kryeministrit,
- Dosja e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i zyrës për buxhet dhe financa i datës 12.09.2019,
- Vendimi Nr.prot:277/2020 i datës 03.12.2020,për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil-dorëheqje,
- Njoftimi pas dorëheqjes E-mail i datës 07.12.2020 dhe E-maili i datës 04.12.2020,
- Vendimi Nr.prot:226/2020 i datës 13.04.2016, për pezullim të dakorduar,
- Vendimi Nr.ref:209/2020 i datës 25.11.2020, i Komisionit Disiplinor,
- Vendimi Nr.prot:1196/2018 i datës 05.12.2018, i Komisionit Disiplinor,
- Vendimi Nr.prot:1197 /2018 i datës 05.12.2018, i Komisionit Disiplinor,
- Kërkesë për informim për buxhet për vitin 2020 dhe E-mail i datë1.04.2020 Qarkore 2020, kufijtë buxhetor për vitin 2020,
- Formali përmbledhës për nëpunësit civilë të vlerësuar me notat ,
- Vendimi Nr.prot:129/2020 i datës 22.04.2020, për përfundimin e pushimit mjekësor,
- Vendimi Nr.prot:980/2019 i datës 13.09.2019, për pushim pa pages, Kërkesa e datës 03.09.2019 për pushim pa pages,
- Vendimi Nr.prot:041/2020 i datës 24.01.2020, për pushim pa pagesë, Kërkesa e datës 24.01.2020 për pushim pa pages
- Vendimi Nr.prot:268/2020 i datës 18.11.2020, për pushim pa pagesë Kërkesa E-maili i datës 13.11.2020, për pushim pa pages, Kërkesë e datës 10.11.2020 ,Vërtetimi i datës 09.11.2020,
- Vendimi Nr.prot:176/2020 i datës 03.07.2020, për Transferim i përhershëm të nëpunësit civil në kuadër të Institucionit të njëjtë, Kërkesë e datës 02.07.2020, Akt emërimi i datës 03.07.2020,
- E-mail: Raporti vjetor i NJJBNJ për vitin 2020, për menaxhimin e burimeve njerëzore në ZKM-së,
- Vendimi Nr.prot:106/2017 i datës 13.02.2017, për pezullim parandalues,
- Vendimi Nr.prot:08/2020 i datës 28.09.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil –vdekjen e nëpunësit,
- Vendimi Nr.prot:207/2019 i datës 13.08.2020, për përfundimin e marrëdhënies së punës-pensionim,
- Vendimi Nr.prot:206/2020 i datës 12.08.2020, për përfundimin e marrëdhënies punës-dorëheqje,
- Vendimi Nr.prot:232/2020 i datës 09.10.2020, për përfundimin e marrëdhënies punës-dorëheqje
- Pasqyra/detajet e pushimeve vjetore për vitin 2020,

Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000
Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmsk.rks-gov.net



- Plani vjetor i trajnimit të nëpunësve civil për periudhën shkurt 2020-dhjetor 2020,
- Vendimi Nr.prot:261/2020 i datës 09.11.2020, për pezullim të dakorduar, me Vendimin Nr.prot:245/2016 e datës 18.04.2016, për pezullim të dakorduar, lidhur me Vendimin e datës 18.04.2016,
- Vendimi Nr.prot:125/2020 i datës 25.03.2020, për pushimin e lehonisë,
- Vendimi Nr.prot:1207/2019 i datës 13.12.2019, për pushimin e lehonisë,
- Vendimi Nr.prot:143/2020 i datës 01.06.2020, për pushimin e lehonisë,
- Vendimi Nr.prot:1282020 i datës 08.04.2020, për pushimin e lehonisë,
- Akt emërimi Nr.prot:155/2021 i datës 11.10.2021, (Young Cell Scheme-YCS),
- Procedura e realizimit të vlerësimit të rezultateve të punës përmes SIMBNJ-së, të bashkangjitur e-mail,
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për vitin 2020, i datë 05.01.2021,
- Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për vitin 2020, i datë 25.01.2021,
- Dosjet e pushimeve Vjetore, në forme elektronike dhe fizike,
- Evidenca e pushimeve mjekësore e vitit 2020.
- Lista e hyrje daljes, Lista e pagave dhe njoftimi nga Njësia e personelit.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe nuk ka dhënë rekomandime përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit .

1. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, gjatë vizitës që ka bërë në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për vitin 2020 me datë 20.01.2022, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr.16/2013 për Strukturën Organizative në Zyrën e Kryeministrit. Në bazë të provave të lëndës e-mailave dhe deklarimit të Udhëheqëses se Divizionit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, lidhur me numrin e nëpunësve civil ka deklaruar se, për vitin 2020 është aprovuar buxheti dhe në muajin Mars, kanë pasur ulje/shkurtim të buxhetit. Në këtë institucion janë 124 pozita të nëpunësve civil të miratuar me buxhet për vitin 2020, ndërsa 5 pozita janë të lira, prej tyre 1 pozitë udhëheqëse/menagjeriale dhe 5 pozita profesionale.

Gjatë këtij viti është plotësuar një (1) pozitë drejtuese, e cila ka qenë e mbuluar me ushtrues në detyrë. a Kurse dy (2) zyrtar të lartë përfitues të burses YCS, janë punësuar me këkresë të aprovuar nga MF, të sistemuar nga MPB/DMZP, dhe një(1) transfer niveli profesional, brenda ZKM pas hyrje në fuqi Ligjit Nr.05/114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në bazë të raportit vjetor të datës 25.01.2021 të Udhëheqëses se Divizionit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, të punësuar aktual janë 121 nëpunës civil, prej tyre 58 meshkuj dhe 63 femra, Shqiptarë njëqind e njeqind e njemëdhjetë (113), Serb dy (2), një (1) Boshnjakë, tre (3) turq, një (1) Goranë dhe një (1) Malazez. Kurse në bazë të kategorisë funksionale, si në vijim: tre (3) në nivel të lartë drejtues, tridhjetë e katër (34) në nivel drejtues, një (1) nëpunës i kësaj kategorie ka qenë në pezullim parandalues me 50% të pagës sipas Ligjit Nr.05/L-149 për Shërbimin Civil, dhe një (1) nëpunës ushtrues në detyrë, tetëdhjetë e dy (82) në nivel profesional dhe dy (2) në nivel teknik administrativ.

Gjatë vizitës së monitorimit, Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka monitoruar dosjet e personelit dhe ka shqyrtuar katër prej tyre, duke konstatuar se janë marrë dy kopje, për pozitën "Zyrtares së lartë për zhvillim të kapaciteteve", dhe pozita "Zyrtares së lartë të personelit", në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit kanë qenë të kompletuara në bazë të dispozitave ligjore të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës më datë 20.01.2022, ka konstatuar që ky institucion ka në zbatim Rregulloren Nr.16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

GJETURA 1. Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, bazuar në dëshmitë e ofruara nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, konfirmohet se është dërguar deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë të Zyrës së Kryeministrit, me datë 17.11.2020 në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe nuk kanë pranuar shkresë zyrtare nga DMZP-së, për komente, kthimin e dokumentacionit për plotësim dokumentacioni apo vërejtje të tjera për deklarim të statusit si dhe konfirmimin për nxjerrjen e vendimit për deklarimin e statusit të nëpunësve civil. Andaj mbi këtë bazë është konstatuar se Njësia Përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës të nxjerrë vendim në bazë të nenit 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik.

REKOMANDIMI 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës që të ndërmarre veprimet e nevojshme që të nxjerrjen vendimet për deklarimin e statusit të nëpunësve civil sic parashihet me Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara, konkretisht gjatë shqyrtimit të Vendimi Nr.prot:012/2020 i datës 10.01.2020, për caktimin e ushtruesit të detyrës, nga Zyrtari i lartë për financa në ushtrim të detyrës "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa", për të cilën pozitë është zhvilluar procedurë e rekrutimit të brendshme dhe është emëruar kandidati i suksesshëm me datë 29.01.2020. Po ashtu është konstatuar se është zbatuar periudha kohore në pajtim me afatin e ushtrimit të detyrës dhe nuk ka pasur tejkalim të afatit, më shumë se tre (3) muaj.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil konstaton se lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës është zbatuar afati ligjore ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu pas hyrjes në fuqi me Aktgjykimin nr.KO203/19, të Gjykatës Kushtetuese, dhe në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke marrë për bazë që pozitën e nivelit drejtues të zëvendësohen nga nëpunësit civil në pajtim me nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka përgatitur planin e personelit për vitin 2020, për vitin 2020, ka pasuar një(1) procedurë të avancimit.

Lidhur me këtë është konstatuar se, për vitin 2020 është zhvilluar një (1) procedurë e rekrutimit për pozitën "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa", e cila procedurë është zhvilluar konform Ligjit Nr. 03/L-149 7

Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000

Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,

web: kpmshck.rks-gov.net

për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe është përfunduar.

Shpallja e konkursi është shpallur me datë 12.09.2019 deri me data 19.09.2019, me Arovim te datës 09.09.2019, Vendimi nr.1010/2019 i datës 23.09.2019 i Komisionit Rekrutues. Me njoftimin e datë 08.10.2019 është pezulluar procedura e rekrutimit të jashtëm sipas njoftimit të MAP-it, deri në miratimin e rregullores për zbatim të Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publik, duke i njoftuar kandidatet për pezullim të procedurës së rekrutimit. Njoftimi Nr.34 i datës 10.01.2020 nga MAP për zbatimin e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe rregulloren në fuqi. Njoftimi i datës 13.01.2020, për vazhdim të procedurës së rekrutimit pas pezullimit, Njoftimi i datës 29.01.2020 për përzgjedhjen përfundimtare.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, në bazë të Vendimit të datës 05.12.2018 nr.prott:1196/2018, për emërimin e Komisionit Disiplinor, i cili është i themeluar prej tre (3) anëtarëve të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve. Në këtë institucion nuk ka të iniciuar ndonjë procedurë disiplinore, me datë 25.11.2020 është nxjerrë Vendimi nr. ref:209/2020 në pajtim me nenin 49 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinë dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, në bazë të provave të marra nga vizita e monitorimit, Vendimi me numër prot:1197/2018 i datës 05.12.2018, për emërimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, është në pajtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në bazë të vlerësimeve në këtë komisioni gjatë vitit 2020, nuk ka pasur ankesa të parashtruara.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit ka bërë të gjitha vlerësimet e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve janë respektuar të gjitha afatet ligjore të vlerësimit. Në këtë rast është konstatuar se vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është bërë në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet në kopje fizike dhe elektronike. Nëpunësit civil kanë realizuar 21 pushimin mjekësor, tetë (8) nëpunëse në pushimin e lehonisë, dhe në bazë të dosjeve të kontrolluara, konstatohet që nëpunësit civil i kanë sjell dëshmitë mjekësore ashtu siç

Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000

Prishtinë, nr tel: +381 33 212 040,

web: kpmshck.rks-gov.net

përcaktohet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullore Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, gjegjësisht Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësit civil, është konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, janë nxjerre tri (3) vendime për pushim pa pagese për nëpunës civil, për lejimin e studimeve, dhe janë zbatuar konform dispozitave të cekura me larte.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, gjatë vitit 2020 ka pasur një (1) transferim të përhershme brenda institucionit nga pozita: "Zyrtar i transportit" në Njësinë e Transportit, në pozitë "Zyrtar Administrativ në Divizionin për mbështetje të trupave Qeveritar/SKQ".

Në bazë të shqyrtimit të dosjeve, konstatohet që janë respektuar procedurat e parapara me të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyrën e Kryeministrit, ka të punësuar 121 nëpunës civil, 113 janë Shqiptar, Serb dy (2), një (1) Boshnjakë, tre(3) turq, një (1) Goranë dhe një (1) Malazez. Prej të cilëve janë 58 meshkuj dhe 63 femra, ndërsa nëpunës civil me nevoja të veçanta nuk kanë të deklaruar në këtë institucion.

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar se:

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 121 nëpunësve civil të punësuar në Zyrën e Kryeministrit, 58 nëpunës janë meshkuj, ndërsa 63 nëpunëse të punësuar janë femra. Në bazë të vlerësimeve në këtë fushë është konstatuar kjo e gjetur:

E GJETURA 1 : Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, ka të punësuar 121 nëpunës civil, nga Njësia e personelit është deklaruar se është një (1) nëpunës civil me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se pjesërisht është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”. Andaj, mbi këtë bazë Zyra e Kryeministrit duhet të bëjë përpjekje që në të ardhmen të plotësoj përqindjen e të punësuarve me aftësi të kufizuara, në raport me numrin e nëpunësve civil në Zyre të Kryeministrit.

REKOMANDIMI 2: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për respektimin e dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

E GJETURA 3: Kolegji i Këshillit për monitorimit e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 121 nëpunësve civil të punësuar në Zyrën e Kryeministrit, 58 janë të punësuar meshkuj dhe 63 janë të punësuar femra, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse. Ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore,

REKOMANDIM 3: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, kanë dy (2) nëpunës me pezullim të dakorduar. Në bazë të vlerësimit të dosjeve tre (3) nëpunës civil kanë marr pushim pa pagesë, tre (3) nëpunësve civil i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dorëheqje, pesë (5) raste të përfundimit të marrëdhënies së punës, një (1) për shkak të vdekjes së nëpunësit civil, një (1) me rastin e pensionimit, kurse raste të tjera si të shkarkimit nga detyra nuk ka pasur.

Në bazë të vlerësimit të dosjeve, është konstatuar se një nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës, me rastin e pensionimit në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil, të cilit i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe akteve nënligjore, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës civil që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak (ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punës me afat të caktuar, dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë).

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për monitorimit e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Zyrën e Kryeministrit, nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË-PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për monitorim të zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, kanë pasur një (1) raste të nëpunësve civil që është duke u zhvilluar procedurë penale, sipas Vendimin Nr.prot:106/2017 të datës 13.02.2017 pezullim parandalues, i nxjerrë në pajtim me nenin 69 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, Plani i trajnimeve, është përgatitur me datë 29.01.2020, dhe i njëjti plan i është dërguar sipas procedurave në DASHC/MAP. Evidencën e trajnimeve të nëpunës civil, mbahet nga Njësia e personelit dhe nxjerrja e raporteve final nga BNJ.

Në bazë të dëshmimeve të ofruara, konstatohet që nëpunësit civil, marrin pjese në trajnime në bazë të ftesave nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike, por gjatë periudhës së pandemisë Covidit-19,

Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000

Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,

web: kpmshck.rks-gov.net

nuk ka pasur ftesa nga IKAP për mbajtjen e trajnimeve me pjesëmarrjen fizike të nëpunësve civil, për vitin 2020.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, vijimin në punë e mban në formë elektronike dhe nxirret raport mujor. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, zyrtaret e IT-së, i gëzojnë shtesë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, nuk ka pranuar vendime të Këshillit për vitin 2020, sepse nuk ka pasur ankesa ndaj këti institucioni dhe po ashtu as nxjerrje të vendimeve.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

15. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR PROCEDURAT E MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të dhënave të dosjeve për fushat e monitorimit, ka arritur të konstatoj tri (3) të gjetura dhe ka dhënë tri(3) rekomandime, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, në këtë kuptim Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, pjesërisht ka arritur që të zbatojë legjislacionin në fuqi në fushat për të cilat janë evidentuar të gjeturat.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur fokus të veçantë në fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e legjislacionit përkatës.

Zyle Millaku-~~GOJNOVCI~~

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

I dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Menaxherit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.

12